

# Raporti i vlerësimit

**Nxitja e Pjesëmarrjes  
Qytetare në Vendimmarrjen  
Vendore përmes Krijimit  
dhe Funkcionimit të**

**OBSERVATORIT QYTETAR**

Orsiola Kurti  
Marsida Çela



Ky raport vlerësimi për performancën e Bashkisë Shijak është përgatitur nga Observatori Qytetar i Bashkisë Shijak mbështetur nga Departamenti për Qeverisje Vendore dhe Zhvillim të Integruar i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe nga Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile. Botimi është realizuar me mbështetjen financiare të Fondacionit për Shoqërinë e Hapur Soros, në kuadër të projektit “Nxitja e Pjesëmarrjes Qytetare në Vendimmarrjen Vendore përmes Krijimit dhe Funkcionimit të Observatorëve Qytetarë”.

## INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM

Rr. Shenasi Dishnica, Nr. 1, Tirana, Albania

P.O.Box 8177, Tirana, Albania

Email: [info@idmalbania.org](mailto:info@idmalbania.org)

Tel: 00355 4 240 0241

Fax: 00355 4 240 0640

[www.idmalbania.org](http://www.idmalbania.org)

---

# Raporti i vlerësimit

**Nxitja e Pjesëmarrjes  
Qytetare në Vendimmarrjen  
Vendore përmes Krijimit  
dhe Funkcionimit të**

**OBSERVATORIT QYTETAR**

Orsiola Kurti  
Marsida Çela

Tiranë, mars 2014

---

# PËRMBAJTJA

<b>Hyrje</b>	<b>5</b>
<b>1. Objektivat dhe Metodologjia</b>	<b>7</b>
1.1 Qëllimi dhe objektivat	7
1.2 Metodologjia	8
<b>2. Analiza e të dhënave</b>	<b>10</b>
2.1 Të dhëna demografike	10
2.2 Cilësia e jetës, infrastruktura dhe shërbimet	12
2.3 Shërbimet publike	14
2.3.1 Uji i pijshëm	14
2.3.2 Shërbimi i Kanalizimit	18
2.3.3 Shërbimi i pastrimit	19
2.3.4 Ndriçimi rrugor	24
2.4 Planifikimi dhe zhvillimi	30
2.5 Pushimi dhe koha e lirë	33
2.5 Veprimtaria administrative dhe pjesëmarrja qytetare	37
<b>3. Gjetje dhe rekomandime</b>	<b>43</b>
<b>Referencat</b>	<b>45</b>

---

# HYRJE

Demokracia dhe sistemi demokratik udhëhiqen nga interesi i qytetarëve që shprehet nëpërmjet pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë ose nëpërmjet aktorëve civilë që zgjidhen nga qytetarët si përfaqësues të tyre. Kësisoj, rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje qëndron në themel të mirëfunksionimit të një sistemi demokratik. Një nga format moderne të pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje është nëpërmjet aktorëve civilë si organizatat e shoqërisë civile (OShC) dhe përfaqësuesve komunitarë. Në Shqipëri, OShC-të në nivel vendor karakterizohen nga burimet e kufizuara, natyra e mbyllur e pa anëtarësi, zhgënjimi i opinionit publik me aktivitetin e tyre dhe me një ndjenjë mosbesimi ndaj të mirës së përbashkët trashëguar prej komunizmit e forcuar më tej gjatë tranzicionit. Sa më sipër, si dhe marrëdhëniet e vështira ndërmjet strukturave të pushtetit në përgjithësi e atij vendor në veçanti kontribuojnë për një pjesëmarrje të dobët qytetare në vendimmarrjen vendore.

Me decentralizimin e funksioneve nga qeveria qendrore tek njësitë e qeverisjes vendore, tashmë politikat vendore duhen hartuar dhe zhvilluar bazuar tek nevojat, prioritetet dhe pritshmëritë specifike të qytetarit dhe jo thjesht të krijohet një zgjatje administrative e këtyre politikave nga niveli qendror drejt atij vendor. Sipas parimit të subsidiaritetit që sanksionohet në Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore<sup>1</sup> ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë nevojitet që politikat vendore të përshtaten

---

<sup>1</sup> <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1962223&Site=Congress&BackColorInternet=C-3C3C3&BackColorIntranet=CACC9A&BackColorLogged=EFEA9C>

me kërkesat e qytetarëve. Si rrjedhojë roli ndikues i qytetarit në këtë drejtim është thelbësor. Demokracia vendore lidhet ngushtësisht me mirëqeverisjen në nivelin vendor. Mirëqeverisja udhëhiqet nga parimet dhe funksionimi i transparencës së organeve të njësive të qeverisjes vendore, përgjegjshmërisë së tyre, llogaridhënies, ushtrimit të pjesëmarrjes qytetare, efektivitetit të politikave publike në nivel vendor dhe efikasitetit në raport me burimet në dispozicion.

Në kuadër të fuqizimit të demokracisë në vendimmarrjen vendore në Bashkinë Shijak përmes ngritjes dhe mirëfunksionimit të Observatorit Qytetar u realizuan monitorime nga grupet e punës së observatorit me asistencën e stafit të IDM-së me qëllim nxitjen e transparencës publike, përmirësimin e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore.

Raporti është konceptuar në tre pjesë: Pjesa e parë jep një përshkrim të shkurtër të qëllimit të realizimit të raportit të monitorimit, metodologjisë të ndjekur nga grupi i observatorit qytetar për ta realizuar atë. Pjesa e dytë është analizë e performancës së Bashkisë Shijak gjatë vitit 2013 duke iu referuar 3 seksioneve të pyetësorëve që janë realizuar me qëllim realizimin e këtij studimi:

1. Të dhëna demografike;
2. Cilësia e jetës, infrastruktura dhe shërbimet;
3. Veprimtaria administrative dhe pjesëmarrja qytetare.

Në këtë pjesë paraqiten analiza e të dhënave për secilin prej seksioneve. Në përfundim jepen gjetjet kryesore dhe rekomandimet.

---

# 1. OBJEKTIVAT DHE METODOLOGJIA

## 1.1 Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i përgjithshëm i monitorimit të performancës së Bashkisë Shijak është paraqitja e ecurisë dhe dinamikës së shërbimeve të ofruara në kuadër të politikave publike. Ky raport synon të japë një analizë të funksionimit të mekanizmave të ngritur në nivel bashkie, të punës së tyre koordinuese midis të gjithë institucioneve që kanë përgjegjësi në ofrimin e shërbimeve publike, si dhe në evidentimin jo vetëm të kënaqshmërisë ndaj këtyre shërbimeve, por edhe në evidentimin e vështirësive dhe pengesave të hasura, duke hedhur piketat për ndërhyrjet premtuese për të patur një ndikim më efektiv dhe efikas në të ardhmen. Vëmendja në raport i kushtohet jo vetëm faktit sesi Bashkia Shijak ka vepruar në mënyrë aktive si faktor ndryshimi duke u përqendruar në politika dhe programe me interes publik, por edhe rolit të shoqërisë civile në tërësi, të medias, organizatave ndërkombëtare si partnerë në zhvillim, si dhe evidentimin e mundësive për forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi në mbështetje të këtyre politikave publike.

Gjithashtu, raporti synon të ngrëjë një model të monitorimit efikas nëpërmjet observatorit qytetar, i cili do të shërbejë edhe si një mbështetje jo vetëm për punën e Bashkisë Shijak por edhe për punën e grupeve përgjegjëse në observimin qytetar duke hedhur piketat për monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të politikave dhe programeve me interes publik, si dhe të mjeteve të nevojshme për të realizuar këtë proces, në

rritjen e përgjegjshmërisë së institucioneve dhe në rritjen e kontributit të shoqërisë civile për të lobuar tek vendimmarrësit, të rolit të tyre.

## 1.2. Metodologjia

Metodologjia e përdorur në funksion të realizimit të këtij raporti përfshin identifikimin e indikatorëve, burimet e të dhënave, procedurat për analizën e të dhënave, si edhe metodat e grumbullimit të të dhënave dhe mjeteve të vlerësimit. Metoda e përgjithshme e përdorur për monitorimin e performancës së Bashkisë Shijak nga Observatori qytetar është kombinimi i të dhënave të disponueshme dhe informacioneve nga burime primare dhe sekondare me të dhënat e marra nga anketimi i kryer me qëllim mbledhjen e informacionit mbi perceptimin dhe nivelin e kënaqshmërisë qytetare. Gjithashtu, ky raport synon të nxisë përgjegjshmërinë dhe besimin e publikut në programet dhe politikat e zbatuara nga Bashkia Shijak në kuadrin e ofrimit të politikave dhe shërbimeve në interes të komunitetit.

Ky raport u zhvillua në harkun kohor Dhjetor-Mars 2014. Metodologjia e përdorur për realizimin e monitorimit performancën e Bashkisë Shijak në kuadër të ofrimit të shërbimeve publike ishte një kombinim i analizës cilësore dhe sasimore duke u bazuar në instrumentet e mëposhtëm:

- **Shqyrtim i dokumentacionit nga burime primare dhe sekondare**

Janë përdorur si burime primare për monitorimin e performancës raporte, informacione mbi politikat dhe programet publike të ndërmarra nga Bashkia Shijak.

Raporte dhe studime të realizuara nga aktorë të tjerë lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë që operojnë në fushën e politikave publike dhe qeverisjes lokale në Bashki kanë shërbyer si burime dytësore.

- **Analiza e të dhënave statistikore zyrtare**

Janë marrë në analizë të dhënat statistikore që disponohen nga INSTAT dhe Bashkia Shijak.

- **Anketimi**



Ky raport monitorimi u realizua përmes një anketimi të bazuar në pyetësorë të strukturuar. Anketimi u realizua me një kampion prej 371 pyetësorësh dhe synonte marrjen e një informacioni më të zgjeruar në lidhje me kënaqshmërinë e komunitetit në procesin e planifikimit, hartimit dhe zbatimit të politikave publike dhe investimeve në nivel vendor.

Kampionimi i popullatës është zgjedhur në mënyrë të rastësishme. Kushti i kampionimit ishte që të intervistuarit të ishin banorë të Bashkisë Shijak dhe të konsiderohej përfshirja e burrave/djemve dhe grave/vajzave gjatë përzgjedhjes së kampionit. Kampionimi për anëtarët e komunitetit të anketuar ishte 371, të cilët u përpunuan. Ky kampion përbëhet nga 215 femra dhe 156 meshkuj. Kohëzgjatja e anketimit ishte 15 minuta. Në tabelën 1 jepet informacion për numrin dhe gjininë e pjesëmarrësve.

*Tabela 1. Gjinia dhe numri i pjesëmarrësve*

<b>Gjinia</b>	<b>Numri</b>
Femër	215
Mashkull	156
Total	371

---


## 2. ANALIZA E TË DHËNAVE

Bashkia Shijak ka qenë gjithnjë e angazhuar në realizimin e planit të komunitetit dhe në ndërmarrjen e nismave që çojnë më tej zhvillimin komunitar. Në kudër të fuqizimit të demokracisë në vendimmarrjen vendore në Bashkinë Shijak përmes ngritjes dhe mirëfunksionimit të Observatorit Qytetar u realizuan monitorime nga grupet e punës së Observatorit me asistencën e stafit të IDM-së me qëllim nxitjen e transparencës publike, përmirësimin e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së Qeverisjes Vendore dhe përdorim eficient dhe efektiv i fondeve publike përmes shmangjes së parregullsirave dhe korrupsionit në përdorimin e parave publike.

### 2.1 Të dhëna demografike


Observatori qytetar anketoj 371 banorë të komunitetit të bashkisë Shijak për të matur nivelin e kënaqshmërisë dhe performancën e pushtetit vendor në ofrimin e shërbimeve. 57,95% e të anketuarve ishin gra dhe 42.05% e tyre ishin burra.

Grafiku 1. Gjendja e punësimit e të anketuarve



Papunësia arrin deri në 10% të popullatës në qytetin e Shijakut. Shifrat e papunësisë janë të larta dhe kjo situatë është shkaktuar për shkak të mbylljeve masive të fabrikave dhe ndërmarrjeve publike në fillim të viteve '90.<sup>2</sup> Rreth 45.55% e të anketuarve rezultojnë të papunë. Pjesa më e madhe e të papunëve janë mbi 40 vjeç dhe të pakualifikuar.

Grafiku 2. Arsimi i të anketuarve



2 Bashkia e Shijakut, Plani i Zhvillimit të Komunitetit 2008 – 2015

## 2.2 Cilësia e jetës, infrastruktura dhe shërbimet

Sipas Planit të Zhvillimit të komunitetit 2008-2015 të Bashkisë Shijak raportohet strehimi i 302 familjeve të pastreha nëpërmjet Vendimet Këshillit nr. 16 dhe 44, datë 1996/07/06 dhe të 1996/02/09. Gjithashtu ky Plani i Zhvillimit raporton rreth 30 familje të pastreha të regjistruara në Shijak.

Aktualisht Bashkia Shijak ka një popullsi prej 7568 banorë.<sup>3</sup>

*Tabela 2. Popullsia e Bashkisë Shijak.*

Përbërja	Moshë			
	0-14	15-64	65+	Total
Femër	649	2621	516	3786
Mashkull	692	2628	462	3782
Total	1341	5249	978	7568


### *Cilësia e jetës*

Cilësia e jetës varet nga sasia e shërbimeve dhe mundësitë që i ofrohen qytetarëve. Gjithashtu, cilësia e ofrimit të shërbimit ndikon ndjeshëm në rritjen e kënaqshmërisë dhe vlerësimit të komunitetit ndaj pushtetit vendor.


Për të matur perceptimet qytetare lidhur me cilësinë e jetës në Bashkinë Shijak, 65.31% e anëtarëve komunitetit që i janë përgjigjur pyetjes mendojnë se cilësia e jetës në Bashkinë Shijak është e mirë. Rreth 14.36% e personave mendojnë se cilësia e jetës është e keqe dhe shumë e keqe respektivisht. Vetëm 9.76% e të intervistuarve që i janë përgjigjur pyetjes mendojnë se cilësia e jetës është shumë e mirë. Shih grafikët që vijojnë.

<sup>3</sup> Censusi 2011, INSTAT

*Grafiku 3. A do të pohoni se cilësia e jetës në bashkinë tuaj në tre vitet e fundit është:*



*Grafiku 4. Sa i kënaqur jeni me sasinë e ujit që ju ofrohet?*



Shumica e anëtarëve që i janë përgjigjur pyetjes në lidhje me cilësinë e jetës në Bashkinë Shijak gjatë tre viteve të fundit (45.63%) mendojnë se cilësia e jetës është përmirësuar disi, ndërsa 29.23% mendojnë se është përkeqësuar disi. Vetëm 7.65% e anëtarëve që i janë përgjigjur pyetjes mendojnë se cilësia e jetës në Bashkinë e tyre gjatë tre viteve të fundit është përmirësuar shumë. 6.01 % është përkeqësuar shumë.


## 2.3 Shërbimet publike

### 2.3.1 Uji i pijshëm


Siguria e furnizimit me ujë të pijshëm ndikohet nga mbrojtja e burimeve që janë kryesisht puse dhe burime natyrore dhe klorinimi i ujit në sistemet e shpërndarjes . Në vendin tonë ekziston një kuadër ligjor dhe rregullor që trajtojnë mbrojtjen e burimeve natyrore, si dhe mbrojtjen e grykave/ fushave të puseve të ujit. Megjithatë, duhet që vetë pushteti vendor të jetë më agresiv në monitorimin rutinë dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e zonave përreth burimeve me puse. Pushtetit vendor i takon të marrë masa ndaj kundërvajtësve, nisur nga kompetenca e tyre për të lëshuar leje ndërtimi.

Plani i zhvillimit të komunitetit për Bashkinë Shijak, paraqet problematike situatën e ujit të pijshëm dhe kanalizimeve. Qyteti merr vetëm 1,5 orë furnizim me ujë të pijshëm në ditë . Megjithatë 43% e anketuarve që i janë përgjigjur pyetjes nëse janë të kënaqur me sasinë e ujit të pijshëm që i u ofrohet, 31% janë të pakënaqur, 14% shumë të pakënaqur dhe vetëm 9% janë shumë të kënaqur (Grafiku 3). 73.5% e anketuarve që i janë përgjigjur pyetjes pohojnë se furnizohen direkt nga sistemi i ujit të pijshëm të qytetit, 21.65% janë përgjigjur JO, dhe 3.99% nuk kanë dijeni (Grafiku 4). Rreth 95.9% përdorin depozitë uji në shtëpinë e tyre (Grafiku 5). Kjo tregon se furnizimi me ujë të pijshëm mbetet ende problematik në qytetin e Shijakut. 78% e anketuarve që i janë përgjigjur pyetjes konfirmojnë se gjatë muajve të fundit kanë pasur furnizim me ujë të pijshëm 1 deri në 4 orë në ditë; 11% kanë pasur furnizim me ujë të pijshëm 5-10 orë në ditë; vetëm 1% ka pasur furnizim 11 ose më shumë orë në ditë; dhe 3% e anketuarve të pyetjes kanë pasur furnizim me ujë 24 orë pa ndërprerje.


Grafiku 5. Sa i/e kënaqur jeni ju nga funksionimi i kanalizimit të ujërave të bardha?




Grafiku 6. A furnizoheni direkt nga sistemi i ujit të pijshëm i qytetit?



Grafiku 7. A përdorni depozitë uji në shtëpinë tuaj?



Grafiku 8. Gjatë gjashtë muajve të shkuar, mesatarisht sa orë në ditë keni pasur furnizim me ujë?




Pyetjes lidhur me mjaftueshmërinë e ujit sipas nevojës gjatë 12 muajve të shkuar (Grafiku 7) pjesa më e madhe e anketuarve që i janë përgjigjur pyetjes, 28% mendojnë ndonjëherë, 26% mendojnë rrallë, 23% mendojnë




zakonisht, 12% mendojnë gjithnjë dhe vetëm 11% mendojnë se nuk kanë pasur asnjëherë ujë të mjaftueshëm sipas nevojave që ata kanë.

*Grafiku 9. Gjatë 12 muajve të shkuar, a keni pasur ujë të mjaftueshëm sa herë që ju është nevojitur?*



*Grafiku 10. Sa i/e kënaqur jeni ju me cilësinë e ujit të pijshëm?*




Pavarësisht klasifikimit mbi mjaftueshmërinë e ujit të pijshëm sipas nevojave gjatë vitit të shkuar sipas grafikut 8, 50% e anketuarve që i janë përgjigjur pyetjes nuk janë të kënaqur me cilësinë e ujit të pijshëm dhe 29% e tyre janë shumë të pakënaqur. 15% shprehen të kënaqur dhe vetëm 4% janë shumë të kënaqur me cilësinë e ujit të pijshëm.


### 2.3.2 Shërbimi i Kanalizimit

Shërbimi i kanalizimeve përcaktohet si mbulimi me shërbim për popullsinë brenda zonës nën administrimin e ndërmarrjeve që e japin këtë shërbim. Sistemi aktual i ujërave të zeza të qytetit të Shijakut ka ende probleme që lidhen me mungesën e investimeve të nevojshme dhe me mungesën e financimit në lidhje me mirëmbajtjen dhe përmirësimin e rrjetit. Shërbimi i kanalizimit është nën administrimin e Bashkisë në kuadër të reformës së decentralizimit. Qytetarët e intervistuar kanë shprehur nivelin e kënaqshmërisë lidhur me këtë shërbim, respektivisht për kanalizimin e ujërave të bardha dhe të zeza.

*Grafiku 11. Sa i/e kënaqur jeni ju nga funksionimi i kanalizimit të ujërave të bardha?*



Grafiku 12. Sa i/e kënaqur jeni ju me funksionimin e kanalizimeve të ujërave të zeza?



Kënaqshmëria e qytetarëve në lidhje me funksionimin e kanalizimeve të ujërave të bardha rezultoi se 9% e anketuarve që i janë përgjigjur pyetjes janë shumë të kënaqur, 48% janë të kënaqur, 25% janë të pakënaqur, 14% janë shumë të pakënaqur, 3% nuk kanë dijeni mbi funksionimin e këtij shërbimi dhe 1% kanë zgjedhur alternativën pa përgjigje (grafiku 10).


Rezultate të ngjashme vërehen edhe mbi kënaqshmërinë e qytetarëve lidhur me funksionimin e kanalizimeve të zeza në qytetin e Shijakut. Shumica e anketuarve që i janë përgjigjur pyetjes 54% shprehen të kënaqur mbi funksionimin e këtij shërbimi, 22% shprehen të pakënaqur, 10% shumë të pakënaqur, ndërsa vetë 8% shumë të kënaqur. 4% e anketuarve nuk kanë dijeni lidhur me këtë shërbim, kurse 2% kanë zgjedhur alternativën pa përgjigje.

### 2.3.3 Shërbimi i pastrimit

Shërbimi i pastrimit financohet nga Bashkia Shijak, e cila kontraktton një kompani private. Sipas Planit të Zhvillimit të Komunitetit 2008-2015 pastrohen rreth 270 ton në muaj dhe pastrimi i këtyre mbetjeve është

kryer për një sipërfaqe prej 42,300 m<sup>2</sup>. Qytetarët e intervistuar për këtë shërbim kanë dhënë perceptimet e tyre lidhur me pastërtinë e qytetit dhe lagjes respektivisht (Grafiku 13; Grafiku 14). Ata kanë nxjerrë problemet më serioze që ndikojnë në papastërtinë e qytetit dhe lagjes (Grafiku 15).

*Grafiku 13. Si do ta vlerësonit pastërtinë e qytetit në përgjithësi?*




Plot 7% e anketuarve që i janë përgjigjur pyetjes vlerësojnë shumë të pastër qytetin (Grafiku 13) dhe 10% e tyre e vlerësojnë shumë të pastër lagjen (Grafiku 14). 61% vlerësojnë të pastër përgjithësisht qytetin dhe 58% lagjen. 26% e vlerësojnë të papastër qytetin në përgjithësi dhe vetëm 24% e tyre vlerësojnë lagjen të papastër. 8% e anketuarve e vlerësojnë lagjen shumë të papastër ndërsa 4% e anketuarve e konsiderojnë qytetin shumë të papastër.


Ndër problemet më serioze që ndikon në papastërtinë e qytetit dhe lagjes në përgjithësi konstatohet mungesa e kulturës qytetare për të cilën 33% e anketuarve që i janë përgjigjur pyetjes mendojnë se njerëzit nuk i hedhin plehrat në vendin e duhur. 28% e personave që i janë përgjigjur pyetjes, konstatojnë mangësinë ose largësinë e koshave; 11% e anketuarve mendojnë si problem serioz në lidhje me papastërtinë grumbullimin e plehrave jashtë kazanëve, 7% mendojnë se makinat e plehrave nuk vijnë rregullisht/vijnë rrallë; 6% janë përgjigjur nuk e di ; 5% konsiderojnë

problem serioz vjedhjen dhe keqpërdorimin e koshave nga njerëzit; 3% e anketuarve konsiderojnë problem serioz mbeturinat e ndërtimeve të lëna pa pastruar. Po ashtu 3% e tyre kanë zgjedhur alternativën pa përgjigje. Ndërsa vetëm 2% mendojnë problem serioz mbeturinat e ndërtimeve të lëna pa pastruar, një tjetër kampion prej 2% kanë specifikuar tjetër arsye si problem serioz në papastërtinë e qytetit dhe lagjes (Grafiku 15).


*Grafiku 14. Si do ta vlerësonit pastërtinë e lagjes tuaj në përgjithësi?*



Grafiku 15. Nëse mendoni se lagjia dhe bashkia është e papastër ose shumë e papastër, cilat do të thonit se janë problemet më serioze?




Grafiku 16. A e keni paguar ju tarifën për shërbimin e pastrimit në qytet për vitin 2013?



Rreth 71% e anketuarve (Grafiku 16) që i janë përgjigjur pyetjes kanë

paguar tarifën e pastrimit për vitin 2013, por vetëm 16 % e tyre janë të gatshëm të paguajnë një tarifë më të lartë për shërbimin e pastrimit. 23% e anketuarve që i janë përgjigjur pyetjes nuk e kanë paguar tarifën e pastrimit për 2013 (Grafiku 16), ndërsa 80% e tyre (Grafiku 17) nuk do donin të paguanin një tarifë më të lartë për pastrimin. Kjo lidhet edhe me nivelin e papunësisë dhe varfërisë që karakterizon popullatën e zonës.

*Grafiku 17. A jeni ju i gatshëm të paguani një tarifë më të lartë për shërbimin e pastrimit?*




Megjithatë, 29% e anketuarve që i janë përgjigjur pyetjes mendojnë se pastrimi dhe mbledhja e mbeturinave mund të përmirësohen nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së njerëzve në ruajtjen e pastërtisë; 20% e tyre mendojnë se përmirësimi vjen në sajë të politikave të shtetit për organizimin e pikave të hedhjes së mbeturinave dhe mbledhjes së tyre; 14% prej tyre mendojnë se grumbullimi duhet bërë në vendin e caktuar për të përmirësuar shërbimin e pastrimit.

Mbi 16% mendojnë se për përmirësimin e shërbimit të pastrimit bashkia të vendosë më shumë kosha të vegjël gjatë rrugës/trotuareve; 4% përkrahin vendosjen e taksave për ata që ndotin mjedisin (edhe makinat) dhe një tjetër 4% mendojnë se mbledhja e rregullt e tarifës së pastrimit përmirëson shërbimin e pastrimit. 6% mendojnë se plehrat duhet të

mblidhen më shpesh, ndërsa 1% janë përgjigjur përmes alternativës tjetër, por pa ofruar specifikime. Vetëm 6% nuk kanë dijeni lidhur me pyetjen.

*Grafiku 18. Si mendoni se mund të përmirësohet pastrimi dhe mbledhja e mbeturinave në bashkinë tuaj?*




### 2.3.4 Ndriçimi rrugor


Shumica e anketuarve (54%, Grafiku 19) që i janë përgjigjur pyetjes se si e vlerësojnë ndriçimin rrugor në qytet, mendojnë se qyteti është pjesërisht i ndriçuar dhe rreth 20% prej tyre e konsiderojnë gjithashtu lagjen e tyre pjesërisht të ndriçuar (Grafiku 20). 20% e anketuarve që i janë përgjigjur pyetjes vlerësojnë se qyteti tyre është i pa ndriçuar (Grafiku 19) ndërsa shumica e anketuarve që i janë përgjigjur pyetjes, rreth 39% vlerësojnë si të pandriçuar lagjen e tyre (Grafiku 20).



Grafiku 19. Si e vlerësoni ndriçimin rrugor në qytetin tuaj?




Grafiku 20. Si e vlerësoni ndriçimin rrugor në lagjen tuaj?



Anëtarët e komunitetit që kanë qenë pjesë e anketimit mendojnë se problemet më serioze lidhur me ndriçimin konsiderohen mungesa e investimeve nga bashkia në ndriçimin publik (39% e tyre, grafiku 19). 27%

e anketuarve që i janë përgjigjur pyetjes konsiderojnë problem serioz ndriçuesit që nuk kanë llamba; 17% e tyre konsiderojnë si problem serioz njerëzit dhe bizneset sepse nuk kanë kulturë qytetare/thyejnë llambat e ndriçimit. 6% e anketuarve të pyetjes mendojnë si problem serioz ndërhyrje në lidhjet publike të paligjshme dhe një tjetër 6% ka specifikuar problem serioze të tjera. 8% nuk kanë dijeni mbi problemet serioze dhe 2% kanë zgjedhur alternativën pa përgjigje.

*Grafiku 21. Nëse mendoni se është pjesërisht e ndriçuar ose e pandriçuar, cilat do të thonit se janë problemet më serioze?*




Mungesa e ndriçimit në qytet ndikon edhe sigurinë e komunitetit në mjediset publike. Sipas Grafikut 22, 52% e anketuarve të pyetjes nuk ndihen aspak të sigurt. 32% e tyre ndihen të sigurt dhe vetëm 19.5% ndihen shumë të sigurt. 8% kanë rrethuar alternativën nuk e di ndërsa 3% atë pa përgjigje.


Në kuadër të përmirësimit të ndriçimit publik qytetarët e anketuar kanë përzgjedhur alternativën që sipas tyre ndikon në përmirësimin e ndriçimit publik. 37% mendojnë se nevojitet mirëmbajtje e infrastrukturës aktuale të ndriçimit publik dhe vendosja e llambave për ndriçuesit; 31% konsiderojnë kryerjen e investimeve publike nga Bashkia si përmirësuese të ndriçimit publik; 8% mbështesin partneritetin publik–privat mes biznesit e bashkisë,

ndërsa 10% kanë paraqitur tjetër alternativë që ndikon në përmirësimin e ndriçimit publik. 6% kanë nuk e dinë çfarë mund të përmirësojë ndriçimin publik dhe 5% kanë zgjedhur alternativën pa përgjigje.

Grafiku 22. A ndiheni ju i sigurt në mjedise publike gjatë natës në qytet?




Grafiku 23. Si mendoni se mund të përmirësohet ndriçimi publik në bashkinë tuaj?



### 2.3.5 Shërbime të tjera infrastrukturore

Shijaku ka 37 rrugë dhe 2 sheshe publike . Në total Bashkia Shijak ka 10455 metra lineare të rrugëve, nga të cilat 5740 janë të shtruara dhe 4715 nuk janë të shtruara . Nga studimi rezulton se rreth 13% e atyre që i janë përgjigjur pyetjes shprehen se janë shumë të kënaqur; 41% shprehen se janë të kënaqur; 24% janë të pakënaqur dhe 11% janë shumë të pakënaqur. Vetëm 1% ka zgjedhur alternativën nuk e di (Grafiku 24).

Grafiku 24. Sa i/e kënaqur jeni ju me gjendjen e rrugëve në bashkinë tuaj?




Gjendja e kopshteve dhe e çerdheve paraqitet e kënaqshme. Rreth 50% e atyre që i janë përgjigjur pyetjes shprehen të kënaqur dhe vetëm 7% shumë të kënaqur. 13% nuk janë të kënaqur dhe vetëm 2% janë aspak të kënaqur. 25% e anketuarve kanë rrethuar alternativën nuk e di për shkak se nuk e aksesojnë ose nuk e kanë të nevojshëm këtë shërbim dhe 3% kanë zgjedhur atë pa përgjigje (Grafiku 25).


Në Bashkinë Shijak ka 3 shkolla 9-vjeçare dhe një gjimnaz të përgjithshëm. Lidhur me gjendjen e shkollave, pjesa më e madhe e atyre që i janë përgjigjur pyetjes, 38% shprehen të kënaqur dhe 7% shprehen shumë të kënaqur. 17% shpreh të pakënaqur dhe 19% shumë të pakënaqur. 17% e anketuarve të pyetjes kanë zgjedhur nuk e di pasi nuk kanë akses/ nuk janë aktualisht në shkollë dhe 2% kanë zgjedhur alternativën pa

përgjigje (Grafiku 26).

Grafiku 25. Sa i/e kënaqur jeni ju me gjendjen e kopshteve dhe çerdheve?




Grafiku 26. Sa i/e kënaqur jeni ju me gjendjen e shkollave në bashkinë tuaj?



Qyteti Shijakut ka një qendër shëndetësore. 40% e anketuarve të pyetjes shprehen të kënaqur nga ky shërbim ndërsa 35% e tyre të pakënaqur.

17% e anketuarve janë shumë të pakënaqur dhe vetëm 4% janë shumë të kënaqur (Grafiku 27).


*Grafiku 27. Sa i/e kënaqur jeni ju me gjendjen e qendrave shëndetësore ne bashkinë tuaj?*




## 2.4 Planifikimi dhe zhvillimi

Me gjithë gjendjen jo të mirë që raportohet në planin e zhvillimit për muzeun, stadiumin dhe qendrën kulturore, 30% e atyre që i janë përgjigjur pyetjes shprehen të kënaqur me mbrojtjen që i bëhet trashëgimisë kulturore në Bashkinë Shijak dhe vetëm 2% shprehen shumë të kënaqur. Nga ana tjetër, 29% janë të pakënaqur dhe 8% janë aspak të kënaqur. Ajo që vërehet nga Grafiku 28 lidhet me përgjigjen e 26% të atyre që i janë përgjigjur pyetjes Nuk e di. Kjo tregon mungesën e njohurisë nga komuniteti mbi trashëgiminë kulturore dhe mungesën e fushatave të ndërgjegjësimit dhe aktiviteteve që lidhen me këtë fushë nga ana e pushtetit vendor.

*Grafiku 28. Sa i/e kënaqur je me mbrojtjen që i bëhet trashëgimisë kulturore në bashkinë tuaj?*



*Grafiku 29. Sa i/e kënaqur jeni ju me punën që bëhet për ruajtjen e ambientit natyror të bashkisë suaj?*




Mirëmbajtja dhe përmirësimi i mjedisit natyror ka qenë një ndër

qëllimet kryesore të planit të zhvillimit. Ndërsa 40% e atyre që i janë përgjigjur pyetjes shprehen se janë të kënaqur me punën që bëhet për ruajtjen e ambientit natyror të Bashkisë Shijak, 30% janë të pakënaqur për këtë çështje. Gjithashtu 16% e anketuarve kanë zgjedhur alternativën nuk e di. Kjo kërkon më shumë punë nga ana e Bashkisë për informimin e qytetarëve mbi ambientin natyror në këtë zonë dhe puna që realizohet për ruajtjen dhe përmirësimin e ambientit (Grafiku 29).


Ekonomia e Shijakut varet nga sektori privat, i cili mbështetet kryesisht në tregti dhe shërbime dhe më pak në prodhim dhe ndërtim. Numërohen rreth 263 biznese nga të cilat 17 janë biznese të mëdha . Kënaqshmëria e komunitetit lidhur me mundësinë për të ndërmarrë një biznes në qytetin ku ata jetojnë shprehet në 20% të kënaqur dhe 22% të pakënaqur. Shumica, rreth 40% nuk shprehin kënaqësi duke zgjedhur alternativën Nuk e di. Kjo lidhet edhe me nivelin e lartë të papunësisë që karakterizon këtë qytet në raport me numrin e popullsisë (Grafiku 30). Niveli i kënaqshmërisë shfaqet edhe për sektorin e punësimit ku rreth 37% që i janë përgjigjur pyetjes shprehen të pakënaqur me punësimin në Bashkinë Shijak (Grafiku 31).

*Grafiku 30. Sa i/e kënaqur jeni ju me mundësinë për të ndërmarrë një biznes në bashkinë tuaj?*






Grafiku 31. Sa i/e kënaqur jeni ju me punësimin në bashkinë tuaj?




## 2.5 Pushimi dhe koha e lirë

Pushimi dhe koha e lirë përbëjnë prioritet jo parësor për Bashkinë e Shijakut. Kjo vërehet nga përgjigjet e pyetjeve që kanë dhënë të anketuarit. Shumica prej tyre janë të pakënaqur me aktivitetet artistike dhe kulturore që zhvillohen në Bashkinë Shijak (41%, Grafiku 32) ndërsa 40% janë të pakënaqur nga aktivitetet sportive që zhvillohen në këtë Bashki (Grafiku 33).

Grafiku 32. Sa i/e kënaqur jeni ju me aktivitetet artistike dhe kulturore që zhvillohen në bashkinë tuaj?




Grafiku 33. Sa i/e kënaqur jeni ju me aktivitetet artistike dhe kulturore që zhvillohen në bashkinë tuaj?



Shërbimi i bibliotekës së Bashkisë Shijak mbetet i mangët duke qenë


së shumica e anketuarve 34% nuk janë aspak të kënaqur. Niveli i interesit për këtë shërbim është i ulët nga komuniteti edhe nga vetë bashkia, duke qenë se 21% e anketuarve nuk e dinë kënaqshmërinë për këtë shërbim (Grafiku 34).

*Grafiku 34. Sa i/e kënaqur jeni ju me shërbimin që ofron biblioteka në bashkinë tuaj?*




Gjithashtu, përsa i përket shërbimeve për rininë mbizotëron përgjigja aspak e kënaqur me 45% dhe i pakënaqur në 37%. Niveli i kënaqshmërisë është vetëm 4%. (Grafiku 35).

Grafiku 35. Sa i/e kënaqur jeni ju me shërbimet që ofrohen për rininë?



Në përgjigjet mbi kënaqshmërinë mbi shërbimet që ofrohet për të moshuarit 39% nuk janë të kënaqur dhe po aq shprehen aspak të kënaqur nga shërbimi që i ofrohet këtij grupi të synuar (Grafiku 36).


Grafiku 36. Sa i/e kënaqur jeni ju me shërbimet që ofrohen për të moshuarit në bashkinë tuaj?



## 2.6 Veprimtaria administrative dhe pjesëmarrja qytetare


Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrjen vendore përbën tregues të demokracisë së konsoliduar. 19% e anketuarve nuk kanë dijeni mbi informimin që bën bashkia në lidhje me aktivitetet dhe shërbimet. 27% mendojnë se informon keq ndërsa 12% mendon se informon shumë keq. Vetëm 29% mendon se në tërësi bashkia informon mirë për aktivitetet dhe shërbimet, ndërsa 11% e vlerësojnë shumë mirë (Grafiku 37).

*Grafiku 37. Në tërësi, sa mirë ju informon bashkia për aktivitetin dhe shërbimet?*




Plot 69% e atyre që i janë përgjigjur pyetjes kanë vizituar bashkinë gjatë 12 muajve të fundit ndërsa 29% nuk e kanë vizituar bashkinë. (Grafiku 38).

Grafiku 38. Gjatë 12 muajve të shkuar, a keni vizituar për çfarëdolloj arsyeje ndonjë zyrë të bashkisë?



Grafiku 39. Nëse po, cila ka qenë arsyeja e kontaktit tuaj më të fundit me këtë zyrë?



Ndër arsyet më të shpeshta të listuara për kontaktin me institucionin

e bashkisë, janë përmendur si më poshtë: për të paguar taksa/tarifa, për të aplikuar apo për të marrë asistencën sociale, për të aplikuar për një licencë biznesi, për të marrë një certifikatë nga zyra e gjendjes civile, për të bërë një pyetje, për të raportuar një problem.

Tabela 3 paraqet vlerësimin e komunitetit ndaj kontakteve në bashki sipas përqindjes së personave që i janë përgjigjur pyetjes kundrejt totalit të anketuarve.

*Tabela 3. Lidhur me këtë kontakt ju lutem vlerësoni secilin nga zërat e mëposhtëm:*

Zërat	Shumë mirë	Mirë	Keq	Shumë keq	Nuk aplikohet	Nuk e di	Pa përgjigje
Sjellja e nëpunësve të bashkisë	16%	63%	6%	5%	0	9%	1%
Shërbimi në kohën e duhur	15%	58%	12%	4%	1%	9%	1%
Përshtatshmëria e orarit zyrtar	18%	53%	9%	3%	1%	15%	1%
Aftësia për të zgjidhur problemin/dhënë përgjigje një pyetjeje	14%	58%	10%	3%	0	13%	2%
Lehtësia për të kontaktuar personin e duhur	16%	62%	6%	3%	0	12%	1%
Qartësia e Informacionit /rregulla dhe procedura të qarta dhe të sakta të vëna në dispozicion qytetarëve	12%	56%	11%	2%	0	17%	2%
Performanca në tërësi në përgjigje të qytetarëve	16%	59%	7%	3%	0	13%	2%

*Tabela 4. Duke shprehur opinionin tuaj personal, ju lutem na thoni sa jeni dakord sipas shkallës së mëposhtme?*

Pyetja	Shumë dakord	Dakord	Jo dakord	Aspak dakord	Nuk e di	Pa përgjigje
Në qoftë se do të kisha një problem dhe do të kisha nevojë për ndihmë nga bashkia, do ta dija menjëherë se ku të drejtohesha.	15%	51%	9%	5%	16%	4%
Bashkia ofron akses të lirë e të lehtë mbi informacionin lidhur me aktivitetet dhe vendimet e saj (p.sh., protokollin e mbledhjeve të këshillit, procedurat e aplikimit për leje biznesi, buxhetin.)	7%	26%	15%	3%	44%	5%
Bashkia ka një strategji afatgjatë për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetit.	8%	34%	15%	5%	33%	5%
Bashkia vepron në mënyrë të ndershme kur lidh kontrata (p.sh., ndërtesa, ndërtime rrugësh, shërbime të tilla si mbledhja e mbeturinave).	8%	25%	12%	7%	43%	5%
Zyrtarët në bashkinë time rrallë veprojnë në mënyrë të pavarur nga qeveria qendrore.	11%	21%	19%	5%	40%	4%
Në procesin e buxhetimit qeveria vendore reflekton prioritetet e qytetarëve.	7%	34%	17%	6%	31%	5%



Pyetja	Shumë dakord	Dakord	Jo dakord	Aspak dakord	Nuk e di	Pa përgjigje
Bashkia aplikon taksa dhe tarifa në mënyrë të ndershme për të gjithë qytetarët.	21%	40%	12%	4%	19%	4%
Bashkia përgjithësisht realizon atë që thotë se do të bëjë.	6%	34%	21%	10%	24%	5%
Zyrtarët e zgjedhur vendorë i kushtojnë më tepër vëmendje asaj që u kërkon partia e tyre se sa asaj që mund të ishte në interes të komunitetit vendor.	11%	22%	13%	7%	37%	10%

*Tabela 5. Gjatë 12 muajve të fundit, thoni përafërsisht se sa shpesh keni kryer aktivitetet e mëposhtme:*

Pyetja	Po, më shumë se 1 herë në muaj	Po, tre ose katër here në vit	Po 1 ose dy here në vit	Jo kurrë	Nuk e di	Pa përgjigje
Keni ndjekur një mbledhje të këshillit bashkiak apo një seancë dëgjimi publik	3%	3%	7%	81%	4%	2%
Keni marrë pjesë në ndonjë komision këshillimor qytetar të organizuar nga bashkia	2%	2%	6%	86%	2%	2%
Keni marrë pjesë në një mbledhje të komunitetit për problemet e qytetit	2%	3%	7%	85%	2%	1%
Keni marrë pjesë vullnetarisht në një grup/aktivitet për të përmirësuar diçka në komunitet	1%	5%	9%	81%	1%	3%

Tabela 6. Sa besim dhe siguri keni tek qeveria vendore?

Pyetja	Shumë	Disi	Pak	Aspak	Nuk e di	Pa përgjigje
Në lidhje me aftësinë e saj për të zgjidhur problemet vendore	15%	49%	19%	11%	5%	1%
Në lidhje me sjelljen e ndershme dhe të drejtë ndaj të gjithë qytetarëve	16%	40%	19%	13%	10%	2%
Në lidhje me respektimin dhe mbështetjen e ligjit	25%	38%	16%	9%	9%	3%

---

## 3. GJETJE DHE REKOMANDIME

- Rritja e kohëzgjatjes së ofrimit të shërbimit me ujë të pijshëm për qytetarët e Bashkisë Shijak, duke qenë se pjesa më e madhe e tyre furnizohet me uje të pijshëm 1-4 orë në ditë
- Përmirësimi i shërbimit të kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza duke qenë se kënaqshmëria qytetare për këtë shërbim është e ulët
- Shërbimi i pastrimit nevojitet t'i përgjigjet kërkesave të qytetarëve duke qenë se vetëm 61% e të pyeturve e vlerësojnë përgjithësisht qytetin të pastër dhe 58% lagjen të pastër.
- Adresimi i problemeve të evidentuara nga qytetarët si shkaktarë të papastërtisë në qytet si nxitja e kulturës qytetare mjedisore dhe ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e njerëzve në ruajtjen e pastërtisë së qytetit, përmirësimi i pikave të hedhjes dhe mbledhjes së mbeturinave, vendosja e një numri më të lartë të koshave të mbeturinave në rrugë/trotuare për të lehtësuar aksesin në distancë të shkurtër, shmangien e grumbullimit të plehrave jashtë kazanëve të plehrave, vendosja e taksave për ndotësit e mjedisit, rritja e shpeshtësisë së mbledhjes së mbeturinave
- Në kuadër të përmirësimit të ndriçimit publik qytetarët mendojnë se nevojitet mirëmbajtje e infrastrukturës aktuale të ndriçimit publik dhe vendosja e llambave për ndriçuesit; kryerjen e investimeve publike nga Bashkia si përmirësuese të ndriçimit publik dhe partneritet publik – privat mes biznesit dhe bashkisë
- Nivelet e kënaqshmërisë në lidhje me shërbime të tjera infrastrukturore

si gjendja e rrugëve, çerdheve, kopshteve dhe shkollave janë pozitive për rreth 50% të të anketuarve

- Vihet re mungesë e njohurive nga komuniteti mbi trashëgiminë kulturore dhe mungesën e fushatave të ndërgjegjësimit dhe aktiviteteve që lidhen me këtë fushë nga ana e pushtetit vendor. Për këtë arsye kërkohen më tepër veprime nga ana e Bashkisë për informimin e qytetarëve mbi ambientin natyror në këtë zonë dhe puna që realizohet për ruajtjen dhe përmirësimin e ambientit
- Kënaqshmëria qytetare në lidhje me mundësitë për të ndërmarrë një biznes në Bashkinë Shijak dhe mundësitë e punësimit është e ulët dhe nevojiten masa për të përmirësuar këto tregues
- Pushimi dhe koha e lirë përbëjnë prioritet jo parësor për Bashkinë e Shijakut duke qenë se shumica e anketuarve janë të pakënaqur në lidhje me aktivitetet sportive, aktivitetet për rininë dhe shërbimin e bibliotekës
- Krijimi i mekanizmave për qartësimin e informacionit /rregullave dhe procedurave të vëna në dispozicion qytetarëve
- Përmirësim i ofrimit të informacionit dhe transparencës së Bashkisë Shijak kundrejt qytetarëve në lidhje me qytetarëve p.sh., protokollin e mbledhjeve të këshillit, procedurat e aplikimit për leje biznesi, buxhetin vjetor
- Përmirësim i shërbimit elektronik të ofrimit të informacionit përmes faqes zyrtare të Bashkisë Shijak
- Përmirësim i transparencës publike në nivel vendor kur lidhen kontrata nga Bashkia (p.sh., për ndërtesa, ndërtime rrugësh, shërbime të tilla si mbledhja e mbeturinave etj.)
- Nevojitet reflektim i prioriteteve të qytetarëve në procesin e buxhetimit vendor
- Nxitje e pjesëmarrjes qytetare në mbledhje të këshillit bashkia, seance dëgjimi publik, mbledhje të komunitetit për probleme të qytetit dhe aktivitete vullnetare për të përmirësuar jetën në qytet
- Rritje e besimit qytetar në lidhje me aftësinë e stafit të institucionit të Bashkisë Shijak për të zgjidhur problemet vendore, sjelljen e ndershme dhe të drejtë ndaj të gjithë qytetarëve dhe në lidhje me respektimin dhe mbështetjen e ligjit.

---

# REFERENCA

- Bashkia Shijak (2008), Plan i Zhvillimit të Komunitetit 2008-2015, Shijak
- NSTAT (2013), Censusi i Popullsisë dhe Banesave, Tiranë
- Karta Europiane e Autonomisw Vendore, <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1962223&Site=COE>, parë për herë të fundit më 14 janar 2014
- Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (2007), Strategjia Kombëtare Sektoriale e Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017, Tiranë